

**NDËRLIDHJA NDËRMJET KUSHTEVE SOCIOEKONOMIKE DHE
DEPRESIONIT PAS LINDJES TEK NËNAT**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER SHKENCOR NË PSIKOLOGJI KLINIKE DHE SHËNDETI**

NGA

ANITA JASHARI-SHEREMETI



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PSIKOLOGJI KLINIKE DHE SHËNDETI
PRISHTINË**

QERSHOR, 2021

Kandidatja:

Anita Jashari - Sheremeti

Mentori:

Mentori: Prof. Ass. Dr. Liridona Jemini-Gashi

Punimi është i organizuar në pesë kapituj:

Kapitulli i I-rë përmban kontekstin e studimit, arsyetimi pse është realizuar ky studim si dhe foksion dhe implikimet e studimit.

Kapitulli i II-të paraqet një vështrim të përgjithshëm të literatures, përkatësisht në këtë kapitull është shqyrtuar literaturë relevante që ka të bëjë për depresionin pas lindjes, çrregullimet e humorit në periudhën pas lindjes, blues pas-lindjes, depresionin psikotik pas-lindjes / psikozat pas-lindjes, depresionin pas-lindjes jo psikotik ose (DPL), kriteret diagnostifikuese sipas DSM V, prevalenca e depresionit pas-lindjes, etiologjinë e depresionit pas-lindjes, dikimin e statusi socio-ekonomik (SES) dhe cilësia e jetës mbi shëndetin e grave dhe mbështetjen sociale për gratë me depresion pas-lindjes, dhunën dhe ndikimi i saj në shfaqjen e depresionit postpartum, ndikimin e depresionit pas-lindjes në fëmijët dhe anëtarët tjerë të familjes, identifikimin e depresionit pas lindjes.

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat:

P1. Sa është niveli i depresionit pas lindjes tek nënat ?

P2. A ekziston dallimi midis nënave me kushte jo të mira social-ekonomike me nënat me kushte më të mira?

P3. Sa ndikon kënaqëshmeria martesore të gratë që ato të kalojnë më lehtë preudhen e paslindjes?

H1. *“Ndërlidhja e depresionit pas lindjes dhe statusit social-ekonomik”*

H2. *“Nënat që kanë lindur foshnjën në kushte jo të mira socio-ekonomike kanë nivel më të lartë të depresionit pas lindjes”.*

H3. *“Do të këtë lidhshmëri negative ndërmjet depresionit pas lindjes dhe kënaqëshmerisë martesore”.*

Kapitulli i III-të është prezantuar metodologjia e studimit, duke filluar nga përshkrimi i popullatës së studimit, mostrës dhe mënyrës së përzgjedhjes së mostrës, përshkrimin e pyetësorit etj.

Kapitulli i IV-të përfshinë analizën e të dhënave dhe rezultatet duke përfshirë: statistikat përshkruese si dhe analizat statistikore më rëndësi konkluduese. Në rezultatet e studimit këtë kapitull janë të paraqitura në mënyrë tabelare por edhe përshkrim narrativ. Hipoteza e parë të këtij studimi ka qenë: *“Ndërlidhja e depresionit pas lindjes dhe statusit social-ekonomik”*, është bërë analiza e korrelacionit [$r = .349$ $p = .565$]. këto rezultate nuk janë të rëndësishme në aspektin statistikor dhe nuk e mbështesin atë. Hipoteza e dytë të këtij studimi ka qenë: *“Nënat që kanë lindur foshnjën në kushte jo të mira socio-ekonomike kanë nivel më të lartë të depresionit pas lindjes”*, është bërë analiza e t-testit dhe ato që janë në marrëdhënie pune dhe kushte më të mira socio-ekonomike kanë raportuar mesatare 11.09 ndërsa ato që nuk janë më punë dhe më kushte më të vështira socio-ekonomike kanë raportuar mesatare 10.96 dhe rezultati i t-testit [$t = .087$, $p = .931$]. Megjithatë këto dallime statistikore nuk janë të rëndësishme në asnjë variant statistikor dhe e hedhin poshtë këtë hipotezë. Hipoteza e tretë të këtij studimi: *“Do të këtë lidhshmëri negative ndërmjet depresionit pas lindjes dhe kënaqëshmerisë martesore”*, është bërë analiza e korrelacionit ndërmjet variablës depresioni pas lindjes dhe kënaqëshmerisë martesore [$r = -.613^{**}$ $p = .000$]. këto rezultate janë të rëndësishme dhe e mbështesin hipotezën e dytë të këtij studimi.

Kapitulli i V-të ka të bëjë me diskutimin e rezultateve, ku rezultatet të cilat janë analizuar, diskutohen në mënyrë kritike dhe analitike, duke i krahasuar ato me studime të ndryshme që janë shqyrtuar në pjesën e literaturës, por edhe duke shprehur qëndrimin e studiuesit në lidhje me to. Në këtë kapitull përfshihen gjithashtu të përmbledhura përfundimet e studimit, limitimet, jepen rekomandime përmes të cilave mendohet se mund të adresohet më mirë dhe të përmirësohet niveli i gjithëpërfshirës por dhe qëndrimeve për këtë dukuri.